

DEKLARATA E BAKU-së

Delegatët e Konferencës së IV EUROSAT/ARABOSAT u takuan në Baku për të diskutuar rreth “ Sfidave Moderne të Ndërtimit të Kapaciteteve të SAT-ve” në datat 17-18 prill 2013.

Ata konfirmuan se:

- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209, datë 22 dhjetor 2011, “Mbi promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit”, është një mjet i fuqishëm që duhet të përdoret nga SAT-t në të gjithë botën për të promovuar qeverisjen e mirë publike, si dhe për të siguruar pavarësinë e tyre;
- Mbështetja dhe bashkëpunimi i dobishëm i të gjithë vendeve anëtare të INTOSAT-t, në veçanti, përpjekjet e bëra nga EUROSAT dhe ARABOSAT, për të vendosur frymën e mirëkuptimit për sfidat e kohëve të fundit, do të kontribuojë në zhvillimin e një përjasje të përbashkët për arritjen e funksioneve të pavarura dhe efektive në auditimin e jashtëm;
- Sfidat e vazhdueshme për shkak të ndryshimeve të menjëhershme të mjedisit kërkojnë ngritjen e kapaciteteve të SAT-ve. Komunikimi efektiv ndërmjet SAT-ve të të njëjtit rajon, shkëmbimi i eksperiencave në përcaktimin e përgjegjësive për autoritetet supreme publike, si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira shërbejnë për të përmirësuar rritjen e kapaciteteve të SAT-ve;
- Roli thelbësor i SAT-ve është përcaktimi i kushteve thelbësore për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, i cili njihet ndërkombëtarisht. Kompleksiteti i auditimeve, të cilat kanë të bëjnë me programe të veçanta në fushën e zhvillimit, si dhe veçanërisht në atë të investimeve publike nëpërmjet partneritetit publik- privat (PPP) është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat SAT-t po përballen;
- Përcaktimi i qartë i kontrollit të jashtëm publik krijon baza të shëndosha për një qeverisje të mirë gjatë zhvillimit të menaxhimit të financave publike.

Inkurajojmë EUROSAT-n dhe ARABOSAT-n, si dhe vendet anëtare të tyre të:

- Krijojnë kushtet e përshtatshme në mënyrë që të përfitojnë nga kapacitetet e INTOSAT-t dhe Grupet Rajonale të tij të Punës në fuqizimin e statuseve dhe mandateve të SAT-ve;
- Të mbështesin iniciativat rajonale në rritjen e ndërgjegjësimit të autoriteteve supreme publike në lidhje me angazhimet që burojnë nga Rezoluta e Kombeve të Bashkuara A/66/209;
- Të zbatojnë sa më shumë standarde ndërkombëtare (ISSAI) ndërkohë që zhvillojnë auditime mbi programet kombëtare të zhvillimit;
- Të rijapin mbështetjen e tyre të plotë për INTOSAT-Donor Cooperation si një mjet efektiv për të rritur partneritetin ndërmjet dy grupeve, si dhe të sigurojnë zbatimin e suksesshëm e standardeve ndërkombëtare ISSAI;
- Të krijojnë mundësi për të aplikuar mënyra moderne për shkëmbimin e eksperiencave, në mënyrë që të përmirësohet ndërtimi i kapaciteteve të SAT-ve të vendeve anëtare;
- Të punojnë për përhapjen e praktikave më të mira në përcaktimin e kuadrit dhe objektivave të sistemit të kontrollit financiar të brendshëm dhe të jashtëm;

Deklarata kërkon që:

- Presidentët dhe Sekretarët e Përgjithshëm të EUROSAT-t dhe ARABOSAT-t ta kalojnë këtë Deklaratë te Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAT-t, si dhe Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Grupeve Rajonale të Punës së INTOSAT-t.